

NEWSLETTER

Qershor

Të Mbrohesh nga
një Sigurim Vetëm
me 5€

Albsig mban Numrin
më të Vogël në Treg
për Dëmet Pezull



Albsig - Pjesë e
Çeljes së Sezoni
Turistik në Lezhë

Produktet e Albsig
më të vlerësuarat
nga Tregu Shqiptar

Albsig tek
Fëmijët e Jetimores
Shkodër për Festën
e 1 Qershorit



Albsig, Dhuratë
Sete Kompjuterash
për Shkollën
“Gjon Buzuku”

Njihuni me Ekspertin e Sigurimeve Motorike
që po Spikat në Treg

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.


MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.







**Të Mbrohesh nga
një Sigurim Vetëm
me 5€**

Në një rrëfim ndryshe, e reja nga Shkodra pas një aksidenti tregon se si përfitoi dëmshpërblimin nga Albsig.

Sezoni turistik sapo ka filluar, prandaj është e rëndësishme që gjatë udhëtimeve jashtë Shqipërie t'i siguron vetes dhe familjes suaj kujdes shëndetësor të mirë, në rast sëmundje ose aksidenti. Me një sigurim të shëndetit në udhëtim me Albsig ju kompesoni shpenzimet për shërim apo hospitalizim emergjent gjatë qëndrimit tuaj në shtete të huaja. Çdo e papritur e padëshiruar në udhëtimet tuaja për pushime apo biznes gjen zgjidhje të shpejtë me ne. Një rast të tillë e tregon dhe 22-vjeçarja nga Shkodra Jona Çemeli. Kjo e fundit tregon përvojën e saj shëndetësore të ndodhur në Çeki para pak muajve.

"Të jesh i siguar është një vlerë e shtuar jo vetëm për financat momentale që disponojmë, por edhe për shëndetin dhe jetën e gjithësecilit prej nesh. Të jesh i siguar dhe ta dish rëndësinë e sigurimeve e sidomos në Shqipëri është një vlerë e shtuar për të gjithë konsumatorët e tregut dhe këtë vlerë unë e gjeta në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, pjesë e "Kastrati Group". Jam shumë e lumtur që përvojën time po e ndaj me ju sepse Albsig është një ndër shoqëritë më të mira të sigurimeve në treg. Është një ndër shoqëritë që klienti për ta është mbret", kështu nis të tregojë eksperiencën e saj me Albsig Jona, kliente e Albsig.

Ajo tregon përvojën në një shtet të huaj, ku vlera e sigurimeve që ajo kishte blerë u bë e pazëvendësueshme. "Kam qenë për një periudhë të konsiderueshme në Çeki, kam qëndruar pothuajse 180 ditë. Në një nga përditshmëritë e mia unë pësova një aksident me biçikletë. Të qenurit larg familjes, por edhe jashtë shteti, t'i bën gjërat më të vështira. Por, duke pasur sigurimin e shëndetit në udhëtim me Albsig çdo gjë e vështirë mu lehtësua", vjon së treguari Jona. Ajo thekson se ka zbatuar me përpikmëri të gjitha hapat udhëzuese në rast dëmi. Njëkohësisht shton se pasi ka bërë të gjitha kontrollet mjekësore dhe ndërhyrjet e duhura ka njoftuar dhe Shoqërinë e Sigurimeve Albsig për dëmin e ndodhur.

"Pasi ndodhisë së aksidentit, në momentin që u bëra e vetëdijshme për atë që më ndodhi, unë lexova të gjitha rregullat që kishte siguracioni dhe brenda afateve të ndodhjes së dëmit unë njoftova dhe Albsig-un", sqaron Çemeli. Ajo shton se çdokush që ka një udhëtim pune apo qejfi jashtë vendi duhet të pajiset patjetër me një sigurim të shëndetit në udhëtim.

Pajisja me sigurimin e duhur mbron jo vetëm financat personale e familjare, por edhe anën psikologjike të gjithësecilit. Sigurimi i shëndetit në udhëtim mbulon të gjitha shpenzimet mjekësore, spitalore, ndërhyrjet kirurgjikale që mund të lindin nga aksidente tek personat që udhëtojnë jashtë vendit, duke asistuar me mbulimin e shpenzimeve spitalore apo farmaceutike në bazë të kontratës së nënshkruar nga kompania siguruese.




Albsig - Pjesë e Çeljes së Sezonit Turistik në Lezhë

Lezha, një qytet historik e mikpritës ka çelur sezonin turistik edhe këtë vit. Falë punës së Bashkisë Lezhë, tashmë ajo është kthyer në atraksion model të turizmit, gastronomisë e pastërtisë urbane. Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e "Kastrati Group" kishte kënaqësinë të ishte pjesëmarrëse në hapjen e sezonit të ri turistik në Shëngjin. Sigurimet e hoteleve dhe rëndësia e tyre ka qenë dhe qëllimi i pjesëmarrjes së Albsig në këtë eveniment.

Albsig është një ndër shoqëritë e sigurimeve që ka bërë të mundur edukimin e biznesit mbi rëndësinë e sigurimeve vullnetare dhe jo vetëm. Gjatë kësaj dite të veçantë u bë e mundur shpërndarja e broshurave informuese rreth sigurimeve për bizneset e zonës. Jo vetëm kaq, por një grup ekspertësh të kësaj fushe informuan drejtuesit dhe pronarët për rëndësinë e sigurimeve të hoteleve dhe bizneseve të tyre në këtë zonë. Ky informacion kishte për qëllim bashkëpunimin në funksion të përvojave me interes të përbashkët dhe mundësimin e ofertave të ndryshme me synim përgatitjen sa më cilësore dhe profesionale të sigurisë së hoteleve dhe jo vetëm.

Manifestim i shkëlqyer në bregdetin e plazhit të Shëngjinit, ku Bashkia Lezhë çeli sezonin e ri turistik të këtij viti, mbledhi bashkë biznese të ndryshme jo vetëm të zonës por dhe më tej. Tashmë, gjithçka është bërë gati dhe operatorët turistikë kanë hapur portat e mikpritjes për pushuesit vendas e të huaj. Shëtitorja e qytetit bregdetar të Shëngjinit u mbush me qytetarë, pushues dhe personalitete të jetës kulturore e politike dhe të ftuar nga Kosova e trojet e tjera shqiptare. Përveç koncertit, nuk munguan dhe takimet me bizneset e zonës për rëndësinë e cilësisë së turizmit duke mos harruar dhe rëndësinë e sigurimeve për ta.



Albsig tek Fëmijët e Jetimores Shkodër për Festën e 1 Qershorit



1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve. Kjo ditë është një festë e madhe e dedikuar tërësisht buzëqeshjeve dhe lumturisë së vogëlushëve kudo në botë. Por nuk është vetëm një ditë festive, kjo është një ditë sensibilizimi për t'i thënë jo dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Është një ditë ndërgjegjësimi ku gjithësecili duhet të hedhë sytë rreth fëmijëve. Prandaj në këtë ditë të shënuar, Shoqëria e Sigurimeve Albsig, përzgjedhi të ishte pranë fëmijëve në Insitucionin "Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç, Shkodër", për të plotësuar dëshirat e tyre, në Ditën e 1 Qershorit, e cila iu dedikohet fëmijëve dhe të drejtave të tyre, në të gjithë botën.

Në kuadër të përgjegjësisë sociale, Shoqëria Albsig ka përzgjedhur, këtë institucion rezidencial të Përkujdesit Social për fëmijët e moshës shkollore, në qytetin e Shkodrës për të përmbushur dëshirat e tyre me disa dhurata simbolike. Dhurata të personalizuar për secilin fëmijë, të blera siç ata kanë kërkuar t'i kishin atë ditë. Njëkohësisht ëmbëlsirat dhe çokollatat nuk munguan për ta në këtë ditë të shënuar. Atmosfera e zbuluar për festë në Institucionin e Përkujdesjes Sociale priti grupin e punës së Albsig të përfaqësuar nga punonjësit e Shkodrës me drejtuese Rozana Marleci, Drejtoreshë, Dega Shkodër 1, ALBSIG.

"Fëmijët janë e ardhmja, e nëse duam të kemi një të ardhme më të mirë duhet të kujdesemi për ata sot, në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me formimin e tyre dhe dhurimin e një fëmijërie sa më të bukur, plot dashuri, si një siguri për një shoqëri të emancipuar nesër". -ishin fjalët dhe motoja e përfaqësueseve të Albsig Shkodër.

Albsig është dhe do të jetë gjithmonë në mbrojtje të fëmijëve dhe të drejtave të tyre në të gjithë vendin. Albsig në kuadër të përgjegjësisë sociale ka mbrojtur gjithmonë të drejtat e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre në vend. Numërohen një sërë aktivitete në kuadër të të drejtave të fëmijëve të mbështetura nga Albsig, jo vetëm në ditën e shënuar të tyre, por edhe ato kur kanë pasur nevojë emergjente.



Damian Zuriqi



Amalia Dakoli



Almir dhe Armand Doci



Darien dhe Heira Ngjeliu




Olen Rama




Rean dhe Marin Jica



Amela Marku




Anja Troshani



Lian Gjonaj



Drini Syllaj



Dionis Kastrati



Roan Lekaj



Martina Dako



Henri Kastrati



Anastasia Tavo

Gëzuar 1 Qershorin nga Fëmijët e Stafit Albsig!



Gledis Basha



Hana Balili



Elia Troshani



Elisia Mano



Gabirel Dako



Mikael Leka



Melodi & Boris Domi



Erneda Kastrati



Ema Pasho



Ines Ahmati



Klari Gjonaj




Roan Kollbaqi



Stivi Marku



Ersa Elezaj



Sidrit Ramaj



1 suksesshëm në “Sigurimin Kasko” në Albsig, Njihuni me Ekspertin e Sigurimeve Motorike që po Spikat në Treg.

Pasionin e tij të madh për makinat e ka shndërruar në profesion dhe angazhim të gjerë, promovim dhe cilësi. Kryeson me produktet dhe shërbimet që disponon. Ai ka vite që është listuar i pari, jo vetëm për Shoqërinë Albsig, por edhe për të gjithë tregun e sigurimeve në vend. Bëhet fjalë për Drejtorinë e Sigurimeve Kasko dhe GPS me drejtues z. Klodian Gjonaj. Në një rrëfim për Newsletter të Albsig, Gjonaj ka treguar sesi iu kultivua vit pas viti kjo ëndërr, e cila tashmë është shndërruar në një realitet të suksesshëm, jo vetëm për të si person, por dhe për kompaninë që përfaqëson. Albsig ofron një gamë të gjerë produktesh dhe opsionesh të zgjedhura me kujdes si dhe të akomoduar për buxhete të ndryshme në ndihmë të çdo pronari automjeteve apo familjari gjithashtu.

Kur keni filluar punë në tregun e sigurimeve, na tregoni pak për ndjesitë e para të punës në një institucion financiar?

Momentin e fillimit e kujtoj gjithmonë me nostalgji. Kjo për faktin se përvojën në sigurime e kam filluar në shtetin fqinj, në Greqi. Gjatë studimeve si çdo i ri edhe unë fillova punë në një prej shoqëritë të sigurimeve në qytetin ku unë jetoja. I apasionuar pas makinave si gjithmonë doja që pasionin që kisha ta ktheja në shërbim të konsumatorëve dhe kjo ëndërr aty nisi. Nga viti 2001 deri në vitin 2004 kam punuar në Greqi me sigurimet e detyrueshme të automjeteve. Aty mësova rëndësinë e sigurimeve dhe mundësinë që iu japin sigurimet financave të çdo familje.

A jeni komod në profesionin Tuaj pas kaq vitesh përvojë?

Me punë, përpjekje dhe sakrificë fitohet dhe komoditeti me profesionin. Edhe unë besoj se deri diku e kam arritur këtë gjë, po duke qenë gjithmonë kërkues besoj se kam shumë punë përpara që të arrij perfeksionin. Ka qenë viti 2006 ku unë u riktheva në atdhe dhe fillova punë në Tiranë në vitin 2007. Eksperienca ime e parë në Shqipëri ndryshonte me atë që kisha përfituar në Greqi, por që ja vlejti shumë. Tashmë hidhem në 10-vjeçarin e dytë të punës në fushën e sigurimeve pasi kam 17 vite punë në këtë treg. Mendoj se edhe në Shqipëri konsumatorët kanë nisur ta vlerësojnë rëndësinë e sigurimit dhe tregu ka qasje tjetër vitet e fundit. Duke patur mungesë të theksuar në fushën e sigurimeve vullnetare, sigurimet e detyrueshme kanë qenë më të njohura dhe më të kërkuara, për këtë dhe Siguimi Kasko i makinave tashmë vlerësohet më shumë.

Po çfarë do të thotë të drejtosh një ekip, pra Drejtorinë e Sigurimit Kasko dhe GPS?

Të drejtosh një ekip do të thotë të punosh me ta për të krijuar një vizion. Çelësi i suksesit që kemi arritur ne si drejtori është puna në grup si një ekip i vetëm, rrjeti i shitjeve dhe bashkëpunimi i ngushtë me konsumatorët dhe tregun për të kuptuar më shumë rëndësinë e produkteve dhe shërbimeve që ne kemi dhe trajtimin ndryshe në serviset më të specializuara për të cilën dhe ne dallojmë. Duke u mbështetur në aftësitë e mia manaxheriale dhe komunikuese, pasioni për profesionin dhe dëshira për të kontribuar nuk më trembin në këtë pozicion pune dhe për këtë çdo gjë ka ecur para. Edhe pse mungesa e edukatës për sigurimet në Shqipëri ka bërë që shumë herë sigurimet të keqinterpretohen, por deri tani çdo gjë ka shkuar siç duhet pasi Albsig është e vetmja shoqëri sigurimesh që ka bërë të mundur edukimin e konsumatorëve dhe i ka orientuar ata drejt sigurimeve vullnetare.

Është e vështirë të realizosh produkte të veçanta dhe paketa siguri për automjetet siç është Sigurimi Kasko, të përcaktosh kushtet dhe rregullat e këtij siguri dhe t'i zbatosh ato në një ambient ku janë mbledhur konsumatorë të niveleve të ndryshme që vijnë nga rrethe të ndryshme, të edukuar ndryshe... në fund të fundit të gjithë jemi të ndryshëm?

Duke ditur që mania e popullit shqiptarë janë makinat, ne jemi munduar t'i përshtatemi tipologjisë së çdo klienti. Duke njohur kërkesën e konsumatorëve, tregun dhe vështirësitë që na janë paraqitur, organizojmë punën sipas një planifikimi të mirëstudiuar. Çelësi i suksesit që kemi arritur si drejtori është puna në grup si një ekip i vetëm drejtori, specialist i shitjeve, specialist i menaxhimit të policave, specialistët e GPS dhe bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë rrjetin e shitjeve të kompanisë kanë bërë të mundur të spikasim një punë të mirë në ndihmë të gjithësecilit prej nesh. Them me shumë kënaqësi se falë punës së vazhdueshme dhe bashkëpunimit të ngushtë sistematik kemi arritur rezultate pozitive duke kryesuar jo vetëm brenda kompanisë, por edhe në të gjithë tregun e sigurimeve.

Cila është motoja juaj në punë dhe çelësi i suksesit të një drejtuesi?

Rritja e cilësisë së punës, harmonia dhe bashkëpunimi i ngushtë me stafin dhe të gjithë hallkat e shoqërisë, sjellin krijimin e një klime pozitive. Çelësi i suksesit të një drejtuesi është puna e studiuar mirë dhe sistematike, bashkëpunimi në vazhdimësi, krijimi i një atmosfere të mirë pune me stafin dhe delegimi me përgjegjshmëri i detyrave për secilin prej tyre.

Në fushën e sigurimeve është më i rëndësishëm shkollimi apo menaxhimi i eksperiencës?

Mendoj se të dyja së bashku kanë rëndësi të veçantë për çdo të ri që starton eksperiencën në këtë fushë. Por ajo që mbizotëron më shumë është eksperiencia në punë. Duke patur eksperiencën bën të mundur dhe qasjen tënde më të shpejtë me tregun e sigurimeve. Të sapodiplomuarve të sotëm dhe sidomos atyre që i kanë sadopak pasion automjetet ju bëj thirrje që të përqëndrohen sa më shumë në tregun e sigurimeve sepse është tregu i së ardhmes.

Cili është hobi juaj, në kohën e lirë? Zakonisht me çfarë merreni?

Një hobi është një mënyrë për të shijuar kohën e lirë duke bërë një aktivitet të kënaqshëm. Në ditët e sotme, për fat të keq, me stresin dhe ritmin e jetës që ne bëjmë... ka shumë njerëz që lenë mënjanë interesat e tyre personale dhe prandaj nuk praktikojnë asnjë lloj hobi. Unë personalisht kam hobi futbollin, ping-pongun, volejbollin dhe udhëtimet. Pas periudhës së pandemisë kam bërë disa udhëtime brenda Shqipërisë, si në skajet më të largëta veriore ashtu dhe ato jugore. Njohja me viset e pashkelura e sidomos në zonat turistike më të veçanta ka qenë dhe pikësnyimi kryesor i imi si familje. Ndërsa paralelisht kam volejbollin dhe ping-pongun. Unë kam nisur ta praktikoj në një moshë shumë të vogël. Ndërsa aktualisht volejboll luajmë dhe të organizuar me stafin e Albsig. Ndërsa për ping-pongun falë përkushtimit të drejtuesve të Albsig ne na është bërë e mundur një sallë ping-pongu dhe në kohën e lirë e praktikoj shpesh këtë lojë.





Albsig, Dhuratë Sete Kompjuterash për Shkollën “Gjon Buzuku”

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group” dhuroi kompjutera për shkollën 9-vjeçare “Gjon Buzuku”, në Tiranë. Fëmijët janë e ardhmja e vendit! Janë gjenerata më e re që do ta bëjnë botën më të mirë. Prandaj, kjo ndihmë vjen nga Albsig në kuadër të projektit SMIP, nisur nga Qeveria Shqiptare. Ky projekt lidhet drejtpërdrejtë me përmirësimin e sistemit arsimor digjital.

“Kjo ndihmë na vjen pikërisht në momentin kur kishim më shumë nevojë, sepse nga viti i kaluar ka filluar programi SMIP, Sistemi i Menaxhimit të Arsimit Parauniversitar, i cili ka të bëjë me regjistrimin e të dhënave në mënyrë digjitale për të gjitha shkollat. Kjo ndihmë na shërben për mësuesit, nxënësit, laboratorin e informatikës dhe për shkollën në tërësi”, u shpreh Zeqir Hasa, nëndrejtori i shkollës 9-vjeçare “Gjon Buzuku”, në Tiranë.

”

Nuk ka dëshirë më të madhe natyrore se sa dëshira për dituri.

Sipas tij thirrjes së menjëhershme për ndihmë të komunitetit të nxënësve të kësaj shkolle i erdhi në mënyrë të menjëhershme Albsig, sepse brezi i ri është e ardhmja e një bote më të mirë.

Shkolla “Gjon Buzuku” është një ndër shkollat më të mira në kryeqytet me një kapacitet të konsiderueshëm nxënësish. Janë rreth 1200 nxënës që mësojnë pranë kësaj shkolle. “Është kënaqësi për Albsigun që bëri këtë donacion modest për të ardhmen e nxënësve të shkollës “Gjon Buzuku” në laboratorin e informatikës”, u shpreh Valbona Dako Drejtoreshë e Marketingut në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig, pjesë e “Kastrati Group”.

Sipas drejtoreshës thirrjeve të tilla do t’i përgjigjet gjithmonë Albsig sepse vlerëson dhe ndihmon gjithmonë gjeneratën e re.



Produktet e Albsig më të Vlerësuarat nga Tregu Shqiptar

Statistikat e AMF, Albsig zë vendin e parë në një gamë produktesh!



01

**Sigurimi
Kasko**

37.72%
e tregut



01

**Sigurimi i
Përgjegjësive
Civile**

47.44%
e tregut



01

**Sigurimi i
Përgjegjësive
të Ndërtuesit**

57.74%
e tregut



01

**Sigurimi i
Garancive**

38.38%
e tregut

Periudha Janar-Prill 2022

Duke provuar produktet dhe shërbimet e Albsig tashmë konsumatorët shqiptarë kanë blerë mbrojtjen më të mirë financiare për veten, familjen dhe automjetet. Tregu i sigurimeve është një pjesë tepër e rëndësishme e sistemit financiar. Për të përfituar nga ky shërbim individët dhe bizneset paguajnë prime sigurimi për t'u mbrojtur nga një ngjarje specifike dhe në rast të ndodhjes së ngjarjes, përfitojnë një shumë të caktuar që në fillim nga kontrata me shoqërinë e sigurimit.

Produktet e Albsig tashmë kryesojnë tregun dhe dallojnë për veçantinë e tyre. Ky fakt vërtetohet menjëherë pas një inspektim të statistikave zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Albsig kryeson tregun prej disa vitesh me Sigurimin Kasko. Bazuar në statistikat zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Sigurimin Kasko, Albsig për muajt Janar-Prill 2022 zë vendin e 1-rë në treg duke me 37.72% të tregut dhe është në mënyrë të vazhdueshme në rritje me një diferencë të lartë dhe qëndron në vendin e dytë me vlerë 54,376 lekë/000. Portofoli Kasko në Albsig është një ndër sigurimet që prej vitesh spikat veçantinë e saj dhe bën "përthithjen" e klientëve në mënyrë të menjëhershme.

Gjithashtu sukseset e produkteve të Albsig nuk kanë të sosur. Stafeta e vendit të parë pasohet dhe për Sigurimin e Përgjegjësive Civile. Për periudhën Janar-Prill 2022 ky produkt kap 47.44% të tregut. Vagonat e suksesit të produkteve të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig vazhdojnë të numërojnë rritje. Pasojnë e kryesojnë vendin e parë dhe Sigurimi për Përgjegjësinë e Ndërtuesit duke zënë 57.74% të tregut për muajt Janar-Prill 2022, si dhe për muajin Prill në vend të 1-rë me 52%. Për ta përmbyllur, është edhe portofoli i Sigurimit të Garancive ku për muajt Janar-Prill 2022 zë vendin e 1-rë në treg me 38.38% të tregut.

Albsig, Mban Numrin më të Vogël në Treg për Dëmet Pezull

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e "Kastrati Group" është një ndër shoqëritë që po spikat në treg për produktet dhe shërbimet e saj. Albsig "nuk të mban pezull" por të shërben me produktet e saj në kohë rekord dhe kundrejt çdo kuadri ligjor. Aktualisht Albsig për 4 mujorin e parë të vitit 2022 është shoqëria në tregun e sigurimeve që ka numrin më të vogël të dëmeve pezull (të papaguara) deri në 30.04.2022. Pra konkretisht në 30.04.2022 janë pezull (të papaguara) vetëm 176 dëme për ALBSIG, ndërkohë që vendi i parafundit ka 296 dëme pezull, pra 120 dëme më shumë dhe i pari ka 3,864 dëme pezull.



30.04.2022

Pagesa e dëmeve në kohë rekord dhe numri më i vogël i dëmeve pezull (të papaguar) janë treguesit kryesor që e bëjnë Albsig-un të jetë ndyshe nga kompanitë e tjera. Shoqëritë e Sigurimeve duket se janë në garë me njëra-tjetrën për të ndërgjegjësuar sadopak, jo vetëm tregun, por të gjithë konsumatorët në përgjithësi.

Ndërgjegjësimi sa vjen e rritet sidomos tek shifrat që sa vijnë e ulen për dëmet pezull dhe ky fakt reflektohet vetëm në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig ku 4 mujorin e parë të 2022 e ka mbyllur me 176 dosje. Albsig rezulton të jetë në vend të 1-rë për sa i përket numrit më të ulët të dëmeve pezull, krahasuar me një vit më parë, duke dëshmuar në këtë mënyrë me fakte reale dhe të monitoruara sipas standardeve të duhura edhe nivelin më të lartë të përgjegjshmërisë së shoqërisë në raport me shërbimin ndaj klientëve të saj.

Shoqëria ka numrin më të pakët të dëmeve pezull sepse sipas përfaqësuesve të Albsig një pjesë e rëndësishme e këtyre dosjeve kanë mbetur pezull për shkak të vendimeve pezull të bashkive në rastin e ngjarjeve nga tërmeti.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL